



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE  
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK GJIROKASTËR**

Nr. 78 Prot

Gjirokastrë , më 19/02/2025

**Lënda: Njoftim për lëvizje paralele**

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE  
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN  
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

**TIRANË**

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.7.2019, "Për krijimin për procedure paralele mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; Udhzimi Nr.759, datë, 30.09.2024 "Për Mënyrën e Organizimit dhe Veprimtarisë, Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Përbërjen e Njesisë së Zhvillimit të Institucioneve ,Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe zhvillimit të vazhduar Profesional të Personelit". Ofruesi publik i AFP-së Qendra e Formimit Profesional Publik, Gjirokastrë ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionet Instruktor për kursin Mobilerë, Kuzhine, Rrobaqepsi, Kujdestar social, Berber, Instalime dhe mirembajtje kondicioneresh, Punime muratimi dhe suvatimi, Aftesi dixhitale baze, Kujdestar Femijesh, Sherbime ne Bar dhe Restorant, Parukeri, Saldim, Instalim dhe Mirembajtje e Rrjetit Elektrik, Instruktor për kursin Instalime dhe Mirembajtje Hidraulike, Pasticeri, Prodhime Brumi, Parukeri, Gurgdhendja per Punime Restauruese Guri, Servis Motori ne Automjetet e Lehta

- Pozicioni

- a) Instruktor për kursin Mobilerë.-- 1 person ( Gjirokastrë)
- b) Instruktor për kursin Kuzhine -- 1 person ( Libohovë)
- c) Instruktor për kursin Rrobaqepsi.-- 1 person ( Gjirokastrë)

- 
- d) Instruktor për kursin Kujdestar Social.-- 1 person ( Gjirokastër)
  - e) Instruktor për kursin Berber.-- 1 person ( Gjirokastër)
  - f) Instruktor për kursin Instalime dhe mirembajtje kondicioneresh.-1 person (Gjirokaster)
  - g) Instruktor për kursin Punime muratimi dhe suvatimi.-- 1 person ( Tepelene)
  - h) Instruktor për kursin Aftesi dixhitale baze.-- 1 person ( Gjirokastër)
  - i) Instruktor për kursin Kujdestar Femijesh .-- 1 person ( Gjirokastër)
  - j) Instruktor për kursin Sherbime ne Bar dhe Restorant 1 person ( Gjirokastër)
  - k) Instruktor për kursin Parukeri 1 person ( Gjirokastër)
  - l) Instruktor për kursin Saldim 1 person ( Gjirokastër)
  - m) Instruktor për kursin Instalim dhe Mirembajtje e Rrjetit Elektrik 1 person ( Gjirokastër)
  - n) Instruktor për kursin Instalime dhe Mirembajtje Hidraulike 1 person ( Gjirokastër)
  - o) Instruktor për kursin Pasteri 1 person ( Gjirokastër)
  - p) Instruktor për kursin Prodhime Brumi 1 person ( Gjirokastër)
  - q) Instruktor për kursin Parukeri 1 person ( Permet)
  - r) Instruktor për kursin Kuzhine 1 person ( Gjirokastër)
  - s) Instruktor për kursin Kuzhine 1 person ( Permet)
  - t) Instruktor për kursin Gurgdhendje per punime restauruese guri.-- 1 person ( Gjirokaster)
  - u) Instruktor për kursin Servis Motori ne Automjetet e Lehta .-1 person (Gjirokaster)

### 1) Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit ;

**Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:**

- a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në fushën/profesionin e kursit/kurseve të formimit profesional, për të cilin po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

### 2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojcës 11 të këtij udhëzimi;

- 
- c) kartën e identitetit;
  - d) diplomën;
  - e) librezën e punës;
  - f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
  - g) certificate ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
  - h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
  - i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
  - j) vërtetim nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
  - k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 26.02.2025

**DREJTOR**

